Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një

institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula



Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e informacionit konfidencial sipas Shtojcës 5
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
(Shënim: Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të çertifikuara të balanceve të tre viteve të fundit **(2015, 2016, 2017)** të operatorit ekonomik pjesmarrës, të paraqitura në autoritetet përkatesë dhe të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit **(2015, 2016 dhe 2017)** ku vlera mesatare e tyre të jete **sa 40% i vleres limit*** të kontrates që prokurohet.

***Shënim*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të kontratave, konkretisht mbi Vlerën e pritshme të kontratave të përcaktuar në pikën 2.8 / Seksioni 2 i DST.*

2.3 Kapaciteti teknik:

- a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të ngjashme në një vlerë sa **40% i vleres limit*** të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
 - Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohet kontrata/kontratat perkatese të shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/te tyre.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen qarte datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

***Shënim*:** Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të kontratave, konkretisht mbi*

Vlerën e pritshme të kontratave të përcaktuara në pikën 2.8 / Seksioni 2 i DST.

b) Per te gjithë artikujt e ofertuar me shenjen asterisko (*) tek nr, në shtojcën 10 më poshtë, duhet te paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date **21.01.2019, Ora: 10:00.** Dorezimi i kampioneve/mostrave, te behet prane Drejtorise Juridike/Sektori Prokurimeve, QSU “Nene Tereza” Tiranë, te mbyllura ne nje zarf/kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit «Furnizim me Materiale Mjekësore ne Shërbimin e Hemodializes në QSUT për vitin 2019-2021 » dhe jo para datës 21.01.2019, ora 10 :00.*
- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te paraqese edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr. Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*
- *Ne paketimin e çdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet te përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuara sipas Nr. Rendor te formularit te ofertes, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.

c) Për të gjithë artikujt e ofruar dhe që janë pjesë e setit sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike/specifikimi i materialeve*), **te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull** (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

ç) Për makinat e hemodializës të ofruara në përdorim, që do të shërbejnë për seancat e trajtimit, **te paraqiten katalogje**, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit

d) Nga ofertuesi kërkohet Autorizimi nga prodhuesi / MAH / distributori i autorizuar (ku të

provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisje/materiale mjekësore në këtë procedurë prokurimi, të perkthyer dhe të noterizuar. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kërkuar (kohëzgjatjen e kontratës lidhur).

e) Deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (Vendi i prodhimit dhe Kompania Prodhuese) për secilin artikull që është pjesë e Setit.

ë) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, për tregetim të materialeve/pajisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

f) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” ose **EN ISO 13485:2003/ EN ISO 13485:2012/ EN ISO 13485:2016** mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*”, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohej të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

g) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autodeklarate për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat **MDD 93/42/EEC** ose **98/34 EC**, ose **CE/DC (Deklarate konformiteti)** kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave perkatese, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

gj) **Operatori Ekonomik** ofertues duhet të paraqesë Autodeklaratë për afatin e skadencës së mallit sipas përcaktimeve në specifikimet teknike të **Shtojces 10**.

h) **Operatori Ekonomik** ofertues, duhet të vertetojë që ka të paktën **1 Inxhinier** në stafin e tij, të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilat do të kryejnë shërbimin e mirëmbajtjes dhe furnizim vendosjes së makinave të dializës, të vertetuar nëpërmjet diplomës, çertifikatave/çertifikatave të trajnimit, CV-se, kontratës individuale të punës.

i) **Operatori Ekonomik** ofertues, duhet të paraqesë Autodeklaratë ku garanton që do të sjellë në përdorim të Autoriteti Kontraktor, 22 makina për trajtim hemodialize (adulte) dhe 5 makina për trajtim hemodialize (pediatrike) të cilat do të stacionohen pranë AK deri në përfundim të marrëveshjes kuadër (dhe kontratave të furnizimit të lidhura gjatë marrëveshjes kuadër) të nënshkruara. Për makinat e dializës adulte dhe pediatrike, duhet të deklarohet modeli i makinës që do të ofrohet në përdorim, prodhuesi dhe viti i prodhimit.

j) **Operatori Ekonomik** duhet të paraqesë Autodeklaratë që makinat e dializës të ofruara në përdorim, do të mirëmbahen nga operatori ekonomik, **me pjesë cilësore, të sigurta dhe origjinale**, pa asnjë kosto shtesë për autoritetin kontraktor dhe Autoriteti Kontraktor, deri në përfundim të kontratës së nënshkruar me Operatorin Ekonomik, do të ketë gjithmonë prezente dhe në gjendje funksionale, 22 makina për trajtim adult dhe 5 makina për trajtim pediatrik.

k) **Operatori Ekonomik** duhet të paraqesë Autodeklaratë, ku garanton Autoritetin Kontraktor,

se në rast defekti të mundshëm të njërit/disave prej aparateve të dializës së ofruar në përdorim, makina/t do të ndërrohet/en menjëherë, me makinë tjetër (**back up-i**) të njëjtit model, minimumi me të njëjtat parametra dhe specifikime teknike, minimumi me të njëjtin vit prodhimi, të cilën operatori ekonomik e mban në gjendje **back-upi (minimalisht 1 makinë backup-i për 5 makina aktive)**, për të garantuar mos-ndërprerjen e shërbimit nga Autoriteti Kontraktor.

l) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike**, për artikujt e kërkuar (**për artikujt e përfshirë në SET si dhe për Makinat e Dializës**)*, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadenca e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatëse për produktet.

***Sqarim: Operatori Ekonomik ofertues**, në mënyrë që të konkludohet me një vlerësim sa më të saktë dhe mosdiskriminues nga AK, **duhet të paraqesë 2 (dy) Oferta Teknike**, ku njëra Oferta Teknike pasqyron artikujt që janë pjesë e Set-it, objekt i kësaj kontrate, dhe një Oferta Teknike tjetër për Makinat e Dializës, që do të ofrohen në përdorim, dhe do të shërbejnë AK për të vlerësuar drejtë përmbushjen e specifikimeve teknike për makinat e dializës.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Public Health Sector

Specifikimi i Materialeve:

Sherbimi I Hemodializes Adulte dhe Pediatrike*				
Nr	Specifikime teknike	Specifikime teknike per materialet mjekesore	Njesia	
1*	Solucion Bikarbonati	Bikarbonat pluhur 600-800g me kartixh kompatibel per makinat	cope	SET për 1 (një) Seancë trajtimi
2*	Solucion acidi	- per dialize me bikarbonat, perqendrimi 1+44, produkt kompatibel i rekomanduar nga manuali i makines - 3,5 l/trajtim	trajtim	
3*	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult	Adult. Me flux te larte; siperfaqe efektive mbi 1.70m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 50 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 115 ml, ; koeficienti I (sieving coefficient) Beta2-microglobulines te jete jo me pak se 0.80 dhe koeficienti (sieving coefficient) i albumines jo me shume se 0.002 (per Qb=300ml/min, Qf=60ml/min)	cope	
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult	Adult. Me flux te larte; siperfaqe efektive mbi 1.3m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 38 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 95 ml, ; koeficienti I (sieving coefficient) Beta2-microglobulines te jete jo me pak se 0.70 dhe koeficienti (sieving coefficient) i albumines jo me shume se 0.0022 (per Qb=300ml/min, Qf=60ml/min)	cope	
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult	Adult. Me flux te larte; siperfaqe efektive mbi 2.0m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 68 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 105 ml, ; koeficienti I (sieving coefficient) Beta2-microglobulines te jete jo me pak se 0.80 dhe koeficienti (sieving coefficient) i albumines jo me shume se 0.002 (per Qb=300ml/min, Qf=60ml/min)	cope	
4*	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik	Pediatrik. Me flux te ulet; siperfaqe efektive jo me pak 1.0m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 8 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 55 ml	cope	
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik	Pediatrik. Me flux te ulet; siperfaqe efektive jo me pak 0.6m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 20 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 35 ml koeficienti I (sieving coefficient) Beta2-microglobulines te jete jo me pak se 0.80 dhe koeficienti (sieving coefficient) i albumines jo me shume se 0.002 (per Qb=300ml/min, Qf=60ml/min)	cope	
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik	Pediatrik. Me flux te ulet; siperfaqe efektive jo me pak 0.2m ² ; koeficienti I ultrafiltrimit jo me pak se 7 ml/ore mmHg, volumi mbushes I gjakut jo me shume se 18 ml	cope	
5*	Set linja arterio-venoze	Adult. Kompatibel per makine dialize. I pajisur me filtra per cdo linje monitorimi presioni arterial/venoz. I pajisur me gote venoze per minimizimin e koagulimit, te pershtatshme per sistemet e monitorimit te pajisjes.	komplet	

Dokumentat Standarde të Tenderit

		Sterilizimi Beta ose Gama		
	Set linja arterio-venoze	Pediatrik. Kompatibel per makine dialize.	cope	
6*	AGE FISTULE ARTERIALE	AGE FISTULE ARTERIALE 16G	cope	
7*	AGE FISTULE VENOZE	AGE FISTULE VENOZE 16G	cope	
8*	Dezinfektant per aparat dialize	Dezinfektant kompatibel per makinen per dezinfektim pastrim dekalçifikim te saj. Kompleti te perfshije sasine e nevojshme per dezinfektim te ftohte per cdo trajtim dialize. Gjithashtu te perfshije dezinfektim te ngrohte si dhe dezinfektim te jashtem te makines	trajtim	
a	Dezinfektant I ftohte	Produkt ekologjik I parrezikshem me nje spekter shume te gjere I rekomanduar per dezinfektim te ftohte qe perdoret per cdo séance dialize	trajtim	
b	Dezinfektant I ngrohte	Perdoret per dezinfektant periodik sipas protokollit. Pa nevojë per test mbetjesh	trajtim	
9*	Dezinfektant I jashtem	ka efekt antibakterial, antiviral	trajtim	

Shënim:

- **Afati i skadencës për materialet duhet të jetë:** *Data e skadencës ne ditën e lëvrimit te mallit duhet te jete jo me e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës se prodhimit dhe asaj te skadencës.*
- Solucionet do te vijne sipas nevojave te Shërbimit, me përqendrimë të ndryshme të elektroliteve K⁺ dhe Ca⁺⁺.
- Sasite e filtrave me sipërfaqe efektive te caktuara mund te ndryshojne me nje perqindje rreth 5 deri 15% ne varesi te specifikave individuale te pacienteve, sipas kërkesës së shërbimit.

Shënim*: *Trajtimi është i llogaritur në SET (pra për një seancë dialize). Për SET-in (për çdo element në tabelën më sipër që shërbejnë për një seancë trajtimi) duhet që Operatorët Ekonomik që do të ofertojnë, në ditën që do të bëhet hapja e procedurës së prokurimit, duhet të paraqesin mostra, sipas kërkesës së parashikuar në Kriteret teknike, germa b.*

Specifikimi i Makinave në përdorim:

MAKINAT E HEMODIALIZËS ADULTE/PEDIATRIKE NË PËRDORIM

Dokumentat Standarde të Tenderit

1	Makinat te jene te reja. Prodhim i 3-viteve te fundit. Te pajisura me certifikate CE.
2	Makinat te kenë strukture pet Acetat, Bikarbonat, Dialize sekuenciale (Ultrafiltrim te izoluar).
3	Te kenë strukture për dialize konvencionale me filtra me fluks te ulet dhe te larte.
4	Te funksionojnë me opsionin me një apo me dy age.
5	Monitorim dhe kontroll te funksioneve te makinës dhe mbrojtjes se pacientit me vetëkontroll nëpërmjet nje monitori lehtësisht te aksesueshem gjate procesit te Hemodializes.
6	Fikje automatike pas përfundimit te ciklit te dezinfektimit.
7	Dekalcifikim dhe pastrim me dezinfektant.
8	Procesi i dezinfektimit te jete i realizueshëm me disa metoda si: <u>Te nxehte, likuid acid citrik, dezinfektim i shkurtër me te nxehte dhe acid citric, dezinfektim kimik, me te ftohte.</u>
9	Memorie mbi eventet e dizinfektimit apo proceseve te tjera qe makina realizon si dhe parametrat e pacientit gjate procesit te dializës.
10	Vete-testim automatik për fillimin e Hemodializes.
11	Kalim nga ultrafiltrim i izoluar ne difuzion.
12	Pompe heparine sipas modulit përkatës.
13	Detektor I ajrit ne sistem me sensor ultrasonic.
14	Detektor i pikimit te gjakut
15	E pajisur me sensor venoze dhe arteriale qe monitorojnë presionet venoze dhe arteriale me diference nga presioni me i ulet ne presionin me te larte jo me te vogel se 400mm Hg.
16	Pompe arteriale te gjakut me shpejtësi te rregullueshme pompimi, me shpejtësi maksimale te paktën 500 ml/min.
17	Ultrafiltrim volumetrik. Kontroll automatik te ultrafiltrimit me paracaktim te volumit total, kohës dhe shpejtësisë se ultrafiltrimit. Shkalla e ultrafiltrimit nga 0-3000 ml/h apo ne diapazon me te gjere.
18	Monitorim dhe profilizim i Na ⁺ , HCO ₃ , te ultrafiltrimit.
19	Te ketë opsionin e ndryshimit te temperaturës se dializatit.
20	Te kete modul per te monitoruar presionin arterial.
21	Te kalkuloje dhe te paraqesë matjet e KT/V gjate seancës.
22	Te kenë mundësinë e lidhjes me nje server qendror.
23	Te jene te pajisura me bateri për vazhdimësinë e procesit te paktën 15 min. duke ruajtur konfigurimet e aparatit.

Dokumentat Standarde të Tenderit

24	Hyrja e fuqisë së makinës 220-240 VAC, 50 Hz.
25	Për çdo 4 pajisje dialize që do të sillen në përdorim, operatori ekonomik duhet të sjellë gjithashtu nga një monitor pacienti për matjen SPO2, BPM dhe ECG. Operatori Ekonomik duhet të vetë-deklarojë modelin e monitorit të pacientit, faktin që kryen matjen SPO2, BPM dhe ECG, si dhe që monitori i pacientit është i certifikuar CE.
26	Kompania të ketë autorizim prodhuesi për makinat e dializës të ofruara.
27	Kompania të jete e certifikuar me ISO 9001:2015.
28	Te ketë të paktën një inxhinier të trajnuar për makinat e dializës nga firma prodhuese.
29	Te sigurojë pajisjen e repartit me një instrument matës për kontrollin e jashtëm të parametrave të aparatit gjatë procesit (temperaturë, konduktivitetin, pH, presionet në hyrje dhe në dalje të dializatit).
30	Te sigurojë mirëmbajtjen periodike të përcaktuar nga protokollin e prodhuesit (filtra, valvula.etj) <i>(Nëpërmjet autodeklaratës së kërkuar në këto Dokumente Tenderi /kapaciteti teknik, germa j).</i>

Shënim:

- **Për ngarkesën ditore të punës bazuar në protokollin e trajtimit, duhet që 22 aparate të jenë në çdo moment në gjendje funksionale të vazhdueshme që të përmbushin plotësimin e nevojave të repartit të dialize adulte dhe 5 aparate të dializës pediatrike;**
- Operatori duhet të pajisë AK me manuale përdorimi dhe servisi me skemat e parashikuara të punës për makinat e hemodializës (adulte/pediatrike) që do të ofrojnë.
- Operatori Ekonomik duhet të trajtojë stafin e Autoritetit Kontraktor, për numrin e personelit të kërkuar nga AK dhe kohëzgjatjes së kërkuar nga AK (Por jo më shumë se 10 ditë pune që fillojnë me kërkesë të AK për trajnim (ku i bashkëlidhet lista e stafit që do të trajnohet) pas instalimit të makinës dhe bërjes funksionale të saj).
- Ofertuesi duhet të paraqesë **grafikun e mirëmbajtjes për pajisjet e dializës (makinat)** sipas manualeve të përcaktuara nga prodhuesi, ku të jete e përcaktuar procedura e kontrollit, pjesët që do të ndërrohen dhe intervalet kohore **sipas protokollit të mirëmbajtjes parandaluese (të përcaktuara nga prodhuesi).**

(Shënim: Paraqitja e grafikut të mirëmbajtjes, nuk nënkupton vënien në dispozicion të manualit të servisit por vënien në dispozicion të shërbimeve që do të kryhen sipas protokollit të mirëmbajtjes parandaluese (sipas prodhuesit) që i duhet kryer pajisjes dhe të cilën do ta kryejë ofertuesi për aparaturat e vena në dispozicion. Kjo zakonisht paraqitet/tregohet në manualet e prodhuesit nëpërmjet llojeve të kontrolleve që kryhen, pjesët e këmbimit që duhet të ndërrohen, shpeshtësinë e kontrolleve etj).

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes		
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia e Set-eve (seancave të trajtimit)			
Nr	Specifikime teknike	Njesia	Sasia orientuese për SET (seancë trajtimi)
1	Solucion Bikarbonati		TOTAL për 2019 - 2021
2	Solucion acidi		
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult		
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult		
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Adult		
4	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik		
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik		
	Filtra Polysulfon ose Polyethersulfon ose Polynephron Pediatrik		
5	Set linja arterio-venoze		
	Set linja arterio-venoze		
6	AGE FISTULE ARTERIALE		
7	AGE FISTULE VENOZE		
8	Dezinfektant per aparat dialize		
a	Dezinfektant I ftohte		
b	Dezinfektant I ngrohte		
9	Dezinfektant I jashtem		



SET për 1 (një)
Seancë trajtimi

37395

Public Health Sector

Afatet e lëvrim:

- **Afati i lëvrim:** Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, do të lidhet kontratë çdo 2 ose 4 (katër) muaj, deri në përfundim të marrëveshjes kuadër:
 - Makinat e dializës (pediatrike dhe adulte) në përdorim, duhet të vihen në dispozicion të Autoritetit Kontraktor pasi të lidhet marrëveshja kuadër, brenda 30 ditëve pas njoftimit të Autoritetit kontraktor, por jo më vonë se 60 ditë nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër.
 - 5 % e sasisë së mallit për secilin material duhet të lëvrohen brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
 - Pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesave të shërbimeve.



Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

kontraktet tino në detyrë të brendshme dhe nevojat ju mësimore të të shtetshëm, sepse
dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së(të mëposhtme:



Public Health Sector

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

Dokumentat Standarde të Tenderit

shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [____]/është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikët e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
